

VETINGU NË DREJTËSI

TRANSPARENCA DHE
LLOGARIDHËNIA E ZYRTARËVE TË LARTË

Raport monitorimi



Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke realizuar projektin “Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy). Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë përgjegjësi e ISP-së.

@Instituti i Studimeve Politike

Tiranë, 2026

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: www.isp.com.al

E-mail: contactaips@isp.com.al

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

Executive Summary	4
Përmbledhje Ekzekutive	5
Metodologjia.....	6
I. HYRJE: NGA MUNGESA E KONTROLLIT TE EKSPOZIMI PUBLIK	6
II. BILANCI STATISTIKOR I VETINGUT: GJETJE DHE TIPARE	7
III. ZYRTARËT E LARTË TË DREJTËSISË SË VJETËR: NJË ANALIZË E BILANCIT	9
IV. TRANSPARENCA E ZYRTARËVE TË LARTË SI PRODUKT I VETINGUT	10
V. LLOGARIDHËNIA E ZYRTARËVE TË LARTË: NGA PËRJASHTIMI NË STANDARD.....	12
VI. KUFIZIMET DHE EFEKTET ANËSORE	13
VII. VLERËSIM PËRFUNDIMTAR: BILANCI 2025–2026.....	14
VIII. REKOMANDIME	16
i. Rekomandime prioritare	16
ii. Rekomandime mbështetëse	17
IX. PËRFUNDIME	18

Executive Summary

This report assesses the real impact of Albania’s judicial vetting process (2025–2026) on transparency, accountability, and the functioning of the justice system. Based on official data— especially from the Special Appeal Chamber (KPA)—and independent monitoring, the findings show that vetting has fundamentally reshaped how accountability operates in Albania.

Vetting represents one of the most far-reaching accountability interventions in post-communist Europe. For the first time, the entire justice system underwent a systematic review of assets, integrity, and professional performance. The data confirm that the process is now largely complete, with most high-level officials having undergone final evaluation.

Three core results stand out. First, transparency has shifted from a formal principle to a daily practice, with decisions published, reasoned, and accessible. Second, accountability has become individual and enforceable, replacing previous patterns of limited or diffuse responsibility. Third, the composition of the justice system has been significantly transformed, with higher integrity standards now in place.

At the same time, the reform has exposed important weaknesses. The large-scale exit of judges and prosecutors has reduced system capacity, increased workloads, and affected efficiency. Financial and infrastructural constraints continue to limit institutional performance. Most critically, the long-term sustainability of vetting outcomes remains uncertain.

In the current phase of Albania’s democratic development and EU integration, transparency and accountability for high-level officials are no longer optional—they are essential. As emphasized also in the framework of National Endowment for Democracy (NED), these principles are key to restoring public trust, strengthening institutions, and ensuring democratic resilience. In this context, vetting should be seen not only as a justice reform, but as a benchmark for accountability across all public institutions.

The key challenge now is consolidation. Vetting was an extraordinary intervention; its success will depend on whether its standards are embedded into permanent institutional practices. The conclusion is clear: vetting changed the system. The next step is to ensure that the system can sustain that change.

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport analizon transparencën dhe llogaridhënien e zyrtarëve të lartë në Shqipëri për periudhën 2025-2026, duke u fokusuar në rastin e procesit të vetingut në drejtësi dhe bilancin e tij real në fazën përmblylëse. Analiza mbështetet në të dhëna zyrtare, veçanërisht nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA), si dhe në raporte monitorimi dhe analiza publike mbi reformën në drejtësi.

Gjetja kryesore e raportit është se vetingu ka prodhuar një transformim të thellë në mënyrën se si funksionon llogaridhënia në sistemin e drejtësisë. Për herë të parë, pothuajse e gjithë elita e drejtësisë iu nënshtrua një procesi të detajuar verifikimi, duke kaluar nga një model me përgjegjësi të kufizuar dhe të shpërndarë, në një model ku llogaridhënia është individuale, e drejtpërdrejtë dhe e verifikueshme.

Bilanci statistikor i KPA përbën një tregues kyç të këtij transformimi. Me qindra çështje të trajtuara dhe vendime përfundimtare të dhëna, procesi i rivlerësimit ka arritur një shtrirje pothuajse të plotë dhe ka përfaqësuar filtrin më të gjerë institucional të zbatuar ndonjëherë në sistemin shqiptar të drejtësisë. Ky bilanc nuk duhet parë vetëm si një përmbledhje numerike, por si një pasqyrë konkrete e përgjegjshmërisë së elitës së mëparshme dhe e ndërhyrjes strukturore të reformës.

Një tjetër dimension thelbësor i analizës lidhet me transparencën. Vetingu ka sjellë një ndryshim rrënjësor nga një sistem i mbyllur dhe me akses të kufizuar në informacion, drejt një modeli ku vendimet janë publike, të arsyetuara dhe të verifikueshme. Institucionet e reja të drejtësisë kanë filluar të institucionalizojnë praktika transparence, duke përfshirë publikimin e vendimeve, raportimin periodik dhe rritjen e aksesit të publikut në informacion. Në këtë kuptim, transparenca është kthyer nga një parim formal në një instrument real kontrolli.

Raporti evidenton gjithashtu se vetingu ka vendosur standarde të reja të integritetit dhe përgjegjshmërisë profesionale. Përmes kontrollit të pasurisë, figurës dhe performancës, është krijuar një bazë e re për ushtrimin e funksionit në drejtësi. Kjo ka çuar në ndërprerjen e vazhdimësisë së elitës së mëparshme dhe në një rikonfigurim të sistemit.

Megjithatë, përkundër këtyre arritjeve, raporti identifikon edhe kufizime të rëndësishme. Largimi masiv i zyrtarëve ka dobësuar përkohësisht kapacitetet e sistemit, duke rritur ngarkesën dhe vonesat në procese. Në të njëjtën kohë, kufizimet financiare dhe infrastrukturore kanë ndikuar në efektivitetin e reformës dhe në aftësinë e institucioneve për të përballuar sfidat e fazës së re.

Një nga shqetësimet kryesore që del nga analiza është rreziku i qëndrueshmërisë. Vetingu ka qenë një mekanizëm i jashtëzakonshëm, i cili ka prodhuar rezultate të rëndësishme, por ruajtja e këtyre rezultateve kërkon mekanizma të përhershëm kontrolli dhe një kulturë të konsoliduar llogaridhënieje. Pa këtë, ekziston mundësia që

disa nga problemet e së kaluarës të rikthehen gradualisht.

Metodologjia

Ky raport bazohet në monitorimin sistematik të institucioneve, proceseve dhe aktorëve që lidhen drejtpërdrejt me sistemin e drejtësisë dhe luftën kundër korrupsionit në Shqipëri. Monitorimi ka përfshirë SPAK-un, 10 gjykata të nivelit të lartë, si dhe institucionet ILD, KLGJ, KLP, KED dhe KPA. Për këtë raport, fokusi analitik është vendosur te KPA dhe procesi i rivlerësimit kalimtar, duke u bazuar në të dhëna të mbledhura nga monitorimi periodik, dokumente dhe statistika zyrtare, vendime publike, si dhe komunikimet zyrtare me institucionet.

I. HYRJE: NGA MUNGESA E KONTROLLIT TE EKSPOZIMI PUBLIK

Periodha 2025–2026 shënon një moment përmbyllës dhe njëkohësisht reflektues për një nga proceset më transformuese të shtetit shqiptar në dekadat e fundit: rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i njohur gjerësisht si vetingu. Në këtë fazë, fokusi nuk është më tek dinamika procedurale e procesit, por tek bilanci i tij real dhe ndikimi që ai ka prodhuar në arkitekturën e sistemit të drejtësisë.

Ky bilanc matet në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes dy dimensioneve themelore: transparencës së sistemit dhe nivelit të llogaridhënies së zyrtarëve të lartë të drejtësisë. Nëse në periudhën para reformës sistemi karakterizohej nga një nivel i ulët kontrolli efektiv, me mekanizma formale dhe shpesh jo funksionale mbikëqyrjeje, periodha e vetingut solli një ndryshim thelbësor në këtë paradigmë.

Vetingu nuk ishte thjesht një proces teknik seleksionimi apo një filtër administrativ për verifikimin e figurës së magistratëve. Ai përfaqësoi një ndërhyrje të thellë strukturore, e cila vendosi për herë të parë një standard të ri marrëdhënieje midis pushtetit dhe përgjegjshmërisë individuale. Përmes këtij procesi, funksionimi i elitës së drejtësisë u bë objekt i një ekspozimi të plotë publik, ku çdo vendim, çdo pasuri dhe çdo element i integritetit profesional iu nënshtrua verifikimit dhe vlerësimit transparent.

Ky ekspozim publik përbën një nga ndryshimet më të rëndësishme të sjella nga reforma. Në një sistem ku më parë mungonte një kulturë e hapjes dhe raportimit, vetingu krijoi një realitet të ri ku vendimmarrja nuk ishte më e mbyllur brenda institucioneve, por e aksesueshme dhe e kuptueshme për publikun. Në këtë mënyrë, transparenca nuk mbeti një parim abstrakt, por u kthye në një instrument konkret kontrolli dhe presioni publik.

Paralelisht, procesi vendosi standarde të reja të llogaridhënies individuale. Çdo zyrtar i

lartë i drejtësisë u vendos përballë detyrimit për të justifikuar jo vetëm aktivitetin profesional, por edhe burimet financiare dhe integritetin etik. Kjo shënon kalimin në një sistem ku përgjegjësia është individuale, e drejtpërdrejtë dhe e verifikueshme.

Në këtë kuptim, *periudha 2025–2026 nuk përfaqëson vetëm fundin e një procesi, por fillimin e një faze të re: atë të vlerësimit të qëndrueshmërisë së standardeve të vendosura*. Pyetja thelbësore që lind në këtë moment është nëse transparenca dhe llogaridhënia, të imponuara fillimisht nga një mekanizëm i jashtëzakonshëm si vetingu, mund të kthehen në elemente të përhershme dhe të brendshme të funksionimit të sistemit të drejtësisë.

II. BILANCI STATISTIKOR I VETINGUT: GJETJE DHE TIPARE

Një nga treguesit më të besueshëm për të vlerësuar realisht ndikimin e vetingut në Shqipëri mbetet bilanci statistikor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA), i cili sintetizon në mënyrë konkrete shtrirjen dhe rezultatet e procesit të rivlerësimit¹. Në ndryshim nga analizat politike, këto të dhëna ofrojnë një bazë empirike për të kuptuar nivelin real të transparencës dhe llogaridhënies së vendosur mbi zyrtarët e lartë të drejtësisë.

Sipas të dhënave zyrtare, gjatë gjithë periudhës së funksionimit të KPA janë trajtuar 442 çështje, janë dhënë 414 vendime, ndërsa vetëm një numër i kufizuar çështjesh mbetet në shqyrtim². Ky bilanc konfirmon se procesi ka hyrë në një fazë përmblylëse dhe se sistemi i drejtësisë ka kaluar përmes një filtri pothuajse të plotë institucional. Në aspektin e llogaridhënies, kjo përkthehet në faktin se pothuajse çdo zyrtar i nivelit të lartë është përballur me një verifikim të detajuar dhe me një vendim përfundimtar mbi vijimin ose jo të karrierës së tij.

Në analizë më të zgjeruar, tabela e KPA për vitet 2018–2025³ tregon një evolucion të qartë të procesit⁴. Në fazat e para, vihet re një volum i lartë çështjesh dhe një rritje progresive e tyre, çka lidhet drejtpërdrejt me natyrën intensive të filtrimit fillestar të sistemit. Kjo fazë, që mund të cilësohet si “*pastrim masiv*”, prodhoi një ndërhyrje të thellë në strukturën e sistemit, duke çuar në largimin e një numri të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe prokurorësh. Siç evidentohet edhe në analizat mbi reformën, kjo ndërhyrje solli pasoja të menjëhershme në funksionimin e sistemit, duke rritur ndjeshëm ngarkesën për subjektet e mbetura dhe duke ndikuar në kohëzgjatjen dhe cilësinë e proceseve gjyqësore⁵.

Në vitet pasuese, procesi hyn në një fazë konsolidimi institucional. Vendimmarrja bëhet

¹ Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA), *Statistika për çështjet JR dhe JD për vitin 2025*, Tiranë, 2025.

² Raport monitorimi mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe efektet e reformës, 2025

³ <https://isp.com.al/wp-content/uploads/2026/03/Statistika-per-ceshtjet-KPA-vitij-2018-2025.pdf>

⁴ Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA), *Tabela statistikore e çështjeve 2018–2025*, Tiranë, 2025.

⁵ Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), *Programi i Transparencës dhe raportimi institucional, 2024–2025*.

më e standardizuar, praktika juridike më e qëndrueshme dhe interpretimi i kritereve të rivlerësimit më i unifikuar. Kjo reflekton kalimin nga një proces me natyrë emergjente drejt një mekanizmi më të strukturuar dhe më të parashikueshëm. Në fazën përfundimtare, gjatë viteve 2024–2025, evidentohet një ulje e ndjeshme e çështjeve në shqyrtim dhe një përmbyllje graduale e backlog-ut, duke sinjalizuar mbylljen ciklike të procesit të vetingut në nivel apelimi.

Megjithatë, rëndësia e këtij bilanci nuk qëndron vetëm te dimensionin sasior. Çdo çështje përfaqëson një zyrar konkret dhe një vendim mbi integritetin, profesionalizmin dhe pasurinë e tij. Në këtë kuptim, të dhënat statistikore përkthehen në një transformim real të elitës së drejtësisë. Largimi i një numri të konsiderueshëm zyrtarësh, i konfirmuar edhe nga analizat empirike të reformës, krijoi një efekt të dyfishtë: nga njëra anë rriti standardet e integritetit, por nga ana tjetër krijoi boshllëqe në kapacitetet njerëzore dhe rriti presionin mbi institucionet ekzistuese⁶.

Një tjetër dimension i rëndësishëm që del nga këto të dhëna është lidhja midis vetingut dhe transparencës institucionale. Procesi i rivlerësimit është shoqëruar me publikimin sistematik të vendimeve dhe me rritjen e aksesit të publikut në informacion. Në mënyrë paralele, institucionet e reja të drejtësisë kanë zhvilluar mekanizma të strukturuar transparence, duke përfshirë publikimin e vendimeve, programe komunikimi dhe akses të hapur në proceset e rekrutimit dhe menaxhimit.

Nga ana tjetër, të dhënat financiare dhe institucionale tregojnë se procesi është zhvilluar në kushte jo gjithmonë optimale. Raportet e monitorimit evidentojnë kufizime në financim dhe në realizimin e buxheteve për sistemin gjyqësor, çka ka ndikuar në ritmin dhe efikasitetin e reformës. Kjo nënvizon një tipar tjetër të rëndësishëm të bilanci të vetingut: ndërsa llogaridhënia është rritur ndjeshëm, kapacitetet institucionale kanë mbetur një sfidë e vazhdueshme.

Në përmbledhje, bilanci statistikor i vetingut paraqet disa tipare kryesore:

- një proces pothuajse të përmbyllur dhe gjithëpërfshirës,
- një ndërhyrje të thellë në elitën e drejtësisë,
- një rritje të ndjeshme të llogaridhënies individuale,
- një institucionalizim gradual të transparencës,
- por edhe kufizime të rëndësishme në kapacitetet dhe burimet e sistemit.

Në këtë kuptim, tabela e KPA nuk është thjesht një instrument statistikor, por një dokument që përmbledh në mënyrë sintetike transformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Ajo përfaqëson njëkohësisht:

⁶ *Ministria e Drejtësisë, Raport monitorimi i Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë 2024–2030 (Janar–Qershor 2025).*

- bilancin e llogaridhënies së zyrtarëve të lartë të drejtësisë së vjetër,
- dhe pikën e nisjes për vlerësimin e qëndrueshmërisë së reformës në vitet pas përfundimit të vetingut.

III. ZYRTARËT E LARTË TË DREJTËSISË SË VJETËR: NJË ANALIZË E BILANCIT

Analiza e bilancit të vetingut nuk mund të kuptohet pa u ndalur te profili dhe funksionimi i elitës së drejtësisë para reformës. Në thelb, procesi i rivlerësimit nuk ndërhyri në një sistem neutral, por në një strukturë që për vite me radhë kishte operuar me nivele të ulëta transparence dhe me mekanizma të kufizuar kontrolli institucional⁷.

Para vitit 2016, sistemi i drejtësisë në Shqipëri karakterizohej nga një mungesë e dukshme e verifikimit efektiv mbi pasurinë dhe integritetin e zyrtarëve të lartë. Deklarimet formale ekzistonin, por kontrolli i tyre ishte i fragmentuar dhe shpesh jo i thelluar. Transparenca institucionale ishte e kufizuar, ndërsa mekanizmat disiplinorë rezultojnë të dobët dhe jo gjithmonë funksionalë. Në këtë kontekst, zyrtarët e lartë të drejtësisë ushtronin funksionet e tyre në një mjedis ku rreziku i përgjegjshmërisë reale ishte relativisht i ulët dhe ku kufizimet institucionale mbi sjelljen profesionale dhe etike ishin minimale.

Ky konfigurim institucional krijoi një kulturë të brendshme ku përgjegjësia individuale nuk ishte e konsoliduar si standard. Vendimmarrja, shpeshherë, mbetej brenda një rrethi të mbyllur profesional, me kontroll të kufizuar nga jashtë dhe me pak mekanizma për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie.

Në këtë sfond, procesi i vetingut veproi si një instrument zbulues dhe verifikues i realitetit të sistemit. Gjetjet e tij treguan se problemet nuk ishin sporadike apo të izoluara, por kishin karakter të gjerë dhe të përsëritur. Një pjesë e konsiderueshme e zyrtarëve të rivlerësuar nuk arritën të justifikonin pasurinë e tyre, duke nxjerrë në pah dobësi të theksuara në raport me standardet e integritetit financiar. Paralelisht, u evidentuan edhe problematika që lidhen me figurën dhe profesionalizmin, duke përfshirë mangësi në performancë dhe në respektimin e standardeve etike⁸.

Këto rezultate, të reflektuara në vendimmarrjen e organeve të vetingut dhe të analizuara gjerësisht në raportet monitoruese dhe në analizat publike, konfirmojnë se sistemi para reformës nuk përballej me probleme të rastësishme, por me një problematikë strukturore⁹. Në terma praktikë, kjo do të thotë se vetingu nuk identifikoi thjesht individë problematikë, por evidentoi kufizimet sistemike të një modeli funksionimi që kishte prodhuar dhe toleruar këto devijime.

⁷ Reporter.al, "Pasqyra e vetingut ekspozoi problemet e thella të sistemit shqiptar të drejtësisë," 18 dhjetor 2024.

⁸ Reporter.al, "Procesi i vetingut po shkon drejt fundit, po tani?," 6 mars 2025.

⁹ Po aty.

Pasojat e këtij procesi u reflektuan drejtpërdrejt në përbërjen e sistemit. Përmes vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA), një numër i konsiderueshëm zyrtarësh të lartë u shkarkuan nga detyra. Krahas tyre, një pjesë tjetër zgjodhi të largohej vetë nga sistemi, duke shmangur procesin ose pasojat e tij, ndërsa vetëm një pjesë e kufizuar u konfirmua në detyrë¹⁰.

Ky rezultat prodhoi një ndërprerje të qartë të vazhdimësisë së elitës së mëparshme. Në aspekt institucional, kjo mund të konsiderohet si një “reset” i sistemit të drejtësisë, ku për herë të parë pas dekadash u krijua një shkëputje reale nga modeli i mëparshëm i drejtpërdrejt në mënyrën se si sistemi koncepton integritetin, përgjegjshmërinë dhe standardet profesionale.

Megjithatë, ky transformim nuk ishte pa kosto. Largimi i një numri të madh zyrtarësh solli boshllëqe të menjëhershme në kapacitetet njerëzore dhe ndikoi në funksionimin normal të gjykatave dhe prokurorive, siç evidentohet edhe në raportet e monitorimit të reformës¹¹. Kjo krijoi një tension të vazhdueshëm midis nevojës për llogaridhënie dhe nevojës për funksionalitet institucional.

Në përmbledhje, analiza e zyrtarëve të drejtësisë së vjetër tregon se vetingu:

- identifikoi dhe ekspozoi dobësi të thella strukturore,
- ndërpreu vazhdimësinë e një elite të konsoliduar,
- dhe vendosi bazat për një model të ri, të ndërtuar mbi standarde më të larta përgjegjshmërie.

Në këtë kuptim, bilanci i vetingut në raport me elitën e mëparshme nuk është vetëm një proces i largimit të individëve, por një transformim i vetë konceptit të ushtrimit të pushtetit në sistemin e drejtësisë.

IV. TRANSPARENCA E ZYRTARËVE TË LARTË SI PRODUKT I VETINGUT

Një nga ndryshimet më të dukshme dhe më të qëndrueshme të sjella nga procesi i vetingut lidhet me transformimin e transparencës në sistemin e drejtësisë. Nëse para reformës sistemi karakterizohej nga një nivel i lartë jo transparence dhe akses i kufizuar i publikut në informacion, periudha pas vetingut ka prodhuar një realitet të ri, ku transparenca është kthyer në një komponent thelbësor të funksionimit institucional¹².

Ky transformim nuk ka qenë thjesht formal, por ka marrë formë konkrete përmes

¹⁰ *Po aty.*

¹¹ *Ministria e Drejtësisë, Raport monitorimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030 (Janar–Qershor 2025).*

¹² *Reporter.al, analiza mbi transparencën dhe efektet e vetingut, 2024–2026*

mënyrës se si institucionet komunikojnë, publikojnë vendimet dhe ndërtojnë marrëdhënien me publikun. Në veçanti, ekspozimi publik i vendimeve të organeve të vetingut dhe publikimi i arsytimeve të detajuara kanë krijuar një standard të ri në sistemin shqiptar të drejtësisë. Për herë të parë, vendimmarrja mbi zyrtarët e lartë nuk ka mbetur e mbyllur brenda institucioneve, por është bërë e aksesueshme dhe e kuptueshme për publikun e gjerë.

Ky nivel transparence është shoqëruar edhe me rritjen e aksesit në informacion, duke i dhënë mundësi medias, shoqërisë civile dhe qytetarëve të ndjekin proceset dhe të vlerësojnë rezultatet. Në këtë mënyrë, transparenca nuk është më një parim abstrakt, por një praktikë e përditshme që ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si perceptohet dhe funksionon drejtësia.

Paralelisht, institucionet e reja të sistemit, si Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), kanë zhvilluar mekanizma të strukturuar transparence, duke përfshirë programe të posaçme, publikimin sistematik të vendimeve dhe rritjen e hapjes së proceseve të rekrutimit dhe menaxhimit të karrierës¹³. Këto zhvillime tregojnë se transparenca nuk ka mbetur një produkt i përkohshëm i vetingut, por është institucionalizuar gradualisht si standard funksionimi.

Në këtë kontekst, transparenca ka marrë një rol të ri edhe si mekanizëm kontrolli. Ndryshe nga e kaluara, ku kontrolli mbi zyrtarët e drejtësisë ishte kryesisht i brendshëm dhe shpesh joefektiv, sot ai shtrihet përtej institucioneve, duke përfshirë publikun dhe median. Kjo krijon një formë të re presioni, e cila nuk bazohet vetëm në procedura formale, por edhe në vëzhgimin dhe reagimin publik.

Ky ndryshim ka dy pasoja kryesore. Së pari, rritet presioni për integritet, pasi çdo vendim apo sjellje profesionale mund të bëhet objekt analize dhe debati publik. Së dyti, forcohet përgjegjshmëria individuale, pasi zyrtarët janë të vetëdijshëm se veprimet e tyre janë të ekspozuara dhe të verifikueshme.

Megjithatë, transparenca si produkt i vetingut mbetet një proces në zhvillim. Ndërsa janë bërë hapa të rëndësishëm drejt hapjes së sistemit, sfida kryesore lidhet me konsolidimin e këtyre praktikave në mënyrë të qëndrueshme dhe të pavarur nga mekanizmat e jashtëzakonshëm që i krijuan ato. Në këtë kuptim, periudha pas përfundimit të vetingut do të jetë vendimtare për të testuar nëse transparenca do të mbetet një standard i brendshëm i sistemit apo do të zbehet gradualisht në mungesë të presionit të jashtëm.

Në përmbledhje, vetingu ka shërbyer si katalizator për transformimin e transparencës në

¹³ Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Programi i Transparencës dhe raportimi institucional, 2024–2025

drejtësi, duke e kthyer atë nga një parim formal në një praktikë konkrete dhe funksionale. Ky transformim përbën një nga arritjet më të rëndësishme të reformës dhe një nga kushtet kryesore për forcimin e llogaridhënies në të ardhmen.

V. LLOGARIDHËNIA E ZYRTARËVE TË LARTË: NGA PËRJASHTIMI NË STANDARD

Një nga transformimet më të rëndësishme që solli procesi i vetingut në Shqipëri lidhet me mënyrën se si konceptohet dhe ushtrohet llogaridhënia në sistemin e drejtësisë. Nëse më parë përgjegjësia e zyrtarëve të lartë ishte shpesh e shpërndarë, e paqartë dhe në disa raste e mbrojtur nga struktura kolektive institucionale, pas vetingut vihet re një zhvendosje e qartë drejt individualizimit të saj¹⁴.

Procesi i rivlerësimit vendosi një standard të ri, sipas të cilit çdo zyrtar i drejtësisë është personalisht përgjegjës për tre elementë themelorë: *pasurinë*, *figurën* dhe *performancën profesionale*. Ky triptik përbën tashmë bazën e vlerësimit të integritetit dhe ushtrimit të funksionit publik. Në këtë kuptim, llogaridhënia nuk është më një koncept abstrakt apo formal, por një detyrim konkret dhe i verifikueshëm, i lidhur drejtpërdrejt me vazhdimësinë në detyrë.

Një nga efektet më të rëndësishme të këtij ndryshimi është zhdukja graduale e asaj që mund të quhet “*mbrojtje kolektive institucionale*”. Në të kaluarën, përgjegjësia shpesh amortizohej brenda strukturave, duke e bërë të vështirë identifikimin dhe ndëshkimin e shkeljeve individuale. Vetingu e theu këtë logjikë, duke vendosur individin në qendër të procesit të verifikimit dhe duke e bërë të pamundur shmangien e përgjegjësisë përmes mekanizmave informalë apo institucionalë.

Megjithatë, vendosja e këtij standardi përmes një procesi të jashtëzakonshëm si vetingu nuk është e mjaftueshme në vetvete. Sfidë kryesore që lind në fazën pas përmbylljes së procesit lidhet me institucionalizimin e llogaridhënies si një praktikë e përhershme. Në këtë drejtim, roli i institucioneve të reja dhe të reformuara të sistemit të drejtësisë është thelbësor.

Institucione si Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) përbëjnë shtyllat kryesore mbi të cilat duhet të mbështetet vazhdimësia e llogaridhënies. Përmes inspektimeve të rregullta, vlerësimeve profesionale dhe procedurave disiplinore, këto institucione kanë përgjegjësinë të garantojnë që standardet e vendosura nga vetingu të mos mbeten një episod i izoluar, por të kthehen në pjesë integrale të funksionimit të sistemit¹⁵.

¹⁴ Reporter.al, analiza mbi efektet e vetingut në llogaridhënie, 2024–2026.

¹⁵ Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), raporte mbi vlerësimin dhe disiplinën e magjistratëve, 2024–2025.

Të dhënat dhe raportet monitoruese tregojnë se këto mekanizma janë vendosur dhe po funksionojnë, por efektiviteti i tyre mbetet i lidhur ngushtë me kapacitetet institucionale, burimet njerëzore dhe financiare, si dhe me pavarësinë e tyre reale në ushtrimin e funksioneve. Në këtë kuptim, kalimi nga një llogaridhënie e imponuar nga jashtë në një llogaridhënie të brendshme dhe të qëndrueshme përbën një nga sfidat kryesore të fazës aktuale.

Në këtë kontekst, llogaridhënia duhet të kuptohet si një proces i vazhdueshëm dhe jo si një ndërhyrje e përkohshme. Vetingu vendosi një bazë të fortë dhe krijoi një precedent të rëndësishëm, por ruajtja dhe forcimi i këtij standardi kërkon mekanizma të përhershëm monitorimi dhe kontrolli. Pa këtë vazhdimësi, ekziston rreziku që standardet e arritura të zbehen gradualisht dhe sistemi të rikthehet në praktika të mëparshme¹⁶.

Në përmbledhje, transformimi i llogaridhënies në sistemin e drejtësisë shqiptare mund të përkufizohet si një kalim nga përjashtimi në standard. Nga një realitet ku përgjegjshmëria ishte shpesh e kufizuar dhe selektive, sistemi ka kaluar drejt një modeli ku llogaridhënia është universale, individuale dhe e institucionalizuar. Sfida kryesore për periudhën në vijim mbetet konsolidimi i këtij modeli dhe garantimi që ai të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme, përtej ndikimit të drejtpërdrejtë të procesit të vetingut.

VI. KUFIZIMET DHE EFEKTET ANËSORE

Pavarësisht arritjeve të rëndësishme në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, procesi i vetingut ka prodhuar edhe një sërë kufizimesh dhe efektesh anësore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit të drejtësisë. Këto pasoja nuk e zbehin rëndësinë e reformës, por evidentojnë kompleksitetin e ndërhyrjes dhe nevojën për masa plotësuese në fazën pas përfundimit të saj.

Një nga efektet më të dukshme lidhet me dobësimin e kapaciteteve njerëzore. Largimi i një numri të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe prokurorësh, si rezultat i shkarkimeve apo dorëheqjeve gjatë procesit të vetingut, krijoi boshllëqe të menjëhershme në strukturën e sistemit. Kjo u reflektua në rritjen e ndjeshme të ngarkesës për subjektet e mbetura në detyrë dhe në zgjatjen e afateve për shqyrtimin e çështjeve. Raportet e monitorimit tregojnë se në disa nivele të sistemit, kjo situatë ka ndikuar në efikasitetin e vendimmarrjes dhe në cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve¹⁷. Në këtë kuptim, ndërhyrja për rritjen e integritetit u shoqërua me një kosto të përkohshme në aspektin e funksionalitetit.

Një tjetër kufizim i rëndësishëm lidhet me dimensionin financiar dhe infrastrukturor të reformës. Të dhënat tregojnë se sistemi i drejtësisë ka operuar shpesh me burime më të

¹⁶ Ministria e Drejtësisë, Raport monitorimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030 (Janar–Qershor 2025).

¹⁷ Raporte monitorimi mbi funksionimin e sistemit gjyqësor pas vetingut, 2025.

ulëta se nevojat reale dhe me nivele të pjesshme të realizimit të buxhetit të planifikuar. Kjo situatë ka ndikuar në aftësinë e institucioneve për të përballuar volumet e shtuara të punës, për të investuar në teknologji dhe për të përmirësuar kushtet e punës. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, këto kufizime ndikojnë në efektivitetin e reformës dhe në kapacitetin e sistemit për të përthithur standardet e reja të vendosura nga vetingu.

Në një plan më afatgjatë, një nga sfidat më të rëndësishme lidhet me rrezikun e rikthimit gradual të praktikave të mëparshme. Vetingu ka vepruar si një mekanizëm i jashtëzakonshëm, i cili ka imponuar standarde të larta kontrolli dhe llogaridhënieje. Megjithatë, në mungesë të mekanizmave të fortë dhe të qëndrueshëm institucionalë, ekziston mundësia që disa nga problemet e së kaluarës të rishfaqen në forma të reja¹⁸. Kjo është veçanërisht e mundshme nëse institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe disiplinën nuk arrijnë të ruajnë të njëjtin nivel rigoroziteti dhe pavarësie.

Në këtë kontekst, sfida kryesore nuk është më vetëm ruajtja e rezultateve të arritura, por ndërtimi i një sistemi që i parandalon në mënyrë të qëndrueshme devijimet. Kjo kërkon jo vetëm kapacitete njerëzore dhe financiare, por edhe një kulturë institucionale të konsoliduar, ku transparencja dhe llogaridhënia të jenë pjesë e brendshme e funksionimit dhe jo të varura nga ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Në përmbledhje, kufizimet dhe efektet anësore të vetingut mund të sintetizohen në tre drejtime kryesore:

- dobësimi i përkohshëm i kapaciteteve funksionale të sistemit,
- kufizimet financiare dhe infrastrukturore,
- dhe rreziku i rikthimit të praktikave të mëparshme në mungesë të mekanizmave të fortë të kontrollit.

Këto elemente nuk e vënë në diskutim domosdoshmërinë e reformës, por nënvizojnë nevojën për një fazë të dytë konsolidimi, e cila duhet të sigurojë që standardet e vendosura nga vetingu të jenë të qëndrueshme dhe afatgjata.

VII. VLERËSIM PËRFUNDIMTAR: BILANCI 2025–2026

Periodha 2025–2026 përfaqëson një moment reflektimi mbi rezultatet reale të reformës në drejtësi dhe, në veçanti, mbi ndikimin e procesit të vetingut në transparencën dhe llogaridhënien e zyrtarëve të lartë. Në këtë fazë, vlerësimi nuk lidhet më me mënyrën se

¹⁸ Ministria e Drejtësisë, Raport monitorimi i Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë 2024–2030 (Janar–Qershor 2025).

si është zhvilluar procesi, por me atë që ai ka prodhuar në mënyrë të qëndrueshme në sistem¹⁹.

Në aspektin e arritjeve, vetingu ka sjellë një ndryshim të dukshëm dhe të matshëm në mënyrën se si funksionon drejtësia. Ai ka krijuar për herë të parë një nivel real transparence, ku vendimmarrja mbi zyrtarët e lartë është bërë publike, e arsyetuar dhe e verifikueshme. Ky zhvillim ka ndikuar jo vetëm në perceptimin publik, por edhe në mënyrën se si vetë institucionet operojnë dhe komunikojnë²⁰.

Një tjetër arritje thelbësore lidhet me vendosjen e llogaridhënies individuale si standard. Përmes procesit të rivlerësimit, çdo zyrtar i drejtësisë është përballur me detyrimin për të justifikuar pasurinë, integritetin dhe performancën profesionale.

Po ashtu, vetingu ka kontribuar në transformimin e standardeve të integritetit në sistem. Përmes vendimeve të organeve të rivlerësimit dhe filtrimit të thellë të trupës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, janë vendosur kritere më të larta për ushtrimin e funksionit publik në drejtësi. Tabela e Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA)²¹, me numrin e lartë të çështjeve të trajtuara dhe vendimeve të dhëna, dëshmon një proces të gjerë dhe të thellë filtrimi, i cili ka prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë elitën e sistemit²².

Megjithatë, përkundër këtyre arritjeve, bilanci i përgjithshëm evidenton edhe kufizime të rëndësishme. Sistemi i drejtësisë mbetet në shumë aspekte i brishtë, veçanërisht për shkak të boshllëqeve në burimet njerëzore dhe kapacitetet institucionale. Largimi i një numri të konsiderueshëm zyrtarësh ka krijuar një presion të vazhdueshëm mbi funksionimin normal të gjykatave dhe prokurorive, duke ndikuar në efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit.

Një tjetër kufizim lidhet me burimet financiare dhe infrastrukturore, të cilat nuk kanë qenë gjithmonë në përputhje me nevojat e reformës. Kjo situatë ka ndikuar në aftësinë e institucioneve për të përballuar sfidat e fazës së re dhe për të konsoliduar standardet e vendosura nga vetingu²³.

Mbi të gjitha, sfida kryesore mbetet qëndrueshmëria e reformës. Vetingu ka qenë një mekanizëm i jashtëzakonshëm, i cili ka prodhuar rezultate të rëndësishme, por ruajtja e këtyre rezultateve kërkon mekanizma të përhershëm dhe funksionalë të kontrollit. Pa një konsolidim të plotë institucional dhe pa një kulturë të qëndrueshme llogaridhënieje, ekziston rreziku që standardet e arritura të dobësohen me kalimin e kohës.

¹⁹ Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA), të dhëna statistikore mbi procesin e rivlerësimit, 2018–2025.

²⁰ Reporter.al, analiza mbi efektet e reformës në drejtësi dhe funksionimin e sistemit, 2024–2026.

²¹ <https://isp.com.al/wp-content/uploads/2026/03/Statistika-per-ceshtjet-KPA-vitii-2018-2025.pdf>

²² Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA), të dhëna statistikore mbi procesin e rivlerësimit, 2018–2025.

²³ Raport mbi financimin dhe kapacitetet e sistemit të drejtësisë, 2024–2025

Në përfundim, bilanci i periudhës 2025–2026 mund të përkufizohet si një kombinim i arritjeve të rëndësishme dhe sfidave të hapura. Vetingu ka transformuar mënyrën se si kuptohet dhe ushtrohet pushteti në sistemin e drejtësisë, por suksesi i tij afatgjatë do të varet nga aftësia e institucioneve për ta kthyer këtë transformim në një standard të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm.

VIII. REKOMANDIME

Bazuar në analizën e bilancit të vetingut, të dhënat e Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA), raportet monitoruese dhe qasjen e projekteve për llogaridhënie publike, rekomandimet e mëposhtme synojnë të mundësojnë kalimin nga një model i llogaridhënies së imponuar në një sistem të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar. Në tërësi, këto rekomandime synojnë të konsolidojnë arritjet e vetingut dhe të shmangin rrezikun që ato të mbeten të përkohshme. Sfida kryesore për periudhën në vijim është kalimi nga një model i llogaridhënies së imponuar nga një proces i jashtëzakonshëm në një sistem të qëndrueshëm, të brendshëm dhe funksional të përgjegjshmërisë institucionale.

i. Rekomandime prioritare

- I. **Forcimi i mekanizmave të përhershëm të kontrollit.** Një nga rreziqet kryesore pas përfundimit të vetingut është rikthimi gradual i praktikave të mëparshme në mungesë të kontrolleve të vazhdueshme. Për këtë arsye, rekomandohet krijimi i një mekanizmi periodik rivlerësimi për zyrtarët e drejtësisë (p.sh. çdo 5–7 vjet), i cili, edhe pse më i lehtë se vetingu, garanton kontroll të vazhdueshëm mbi pasurinë, figurën dhe performancën.
- II. **Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale.** Boshllëqet e krijuara nga largimet masive kanë ndikuar drejtpërdrejt në funksionalitetin e sistemit. Nevojitet një politikë e qëndrueshme rekrutimi dhe promovimi, si dhe forcimi i rolit të Shkollës së Magjistraturës për të garantuar një trupë profesionale cilësore dhe afatgjatë.
- III. **Sigurimi i financimit të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm.** Kufizimet buxhetore kanë reduktuar kapacitetin e sistemit për të përballuar efektet e reformës. Financimi i drejtësisë duhet të trajtohet si prioritet strategjik, duke garantuar burime të qëndrueshme për funksionim, investime teknologjike dhe përmirësim të kushteve të punës.

- IV. **Forcimi i rolit të institucioneve të reja të drejtësisë.** Institucione si ILD, KLGJ dhe KLP mbeten kyçe për fazën pas vetingut. Rekomandohet forcimi i kapaciteteve hetimore, rritja e transparencës së veprimtarisë dhe garantimi i pavarësisë së tyre funksionale nga ndërhyrjet politike apo institucionale.
- V. **Krijimi i një sistemi të unifikuar dhe transparent për deklarimet e pasurisë.** Fragmentarizimi aktual i të dhënave kufizon kontrollin efektiv. Një platformë e integruar dhe e hapur do të mundësonte transparencë të plotë, krahasim ndër vite dhe monitorim më efikas nga institucionet dhe publiku.

ii. Rekomandime mbështetëse

- I. **Zgjerimi i llogaridhënies përtej sistemit të drejtësisë.** Vetingu krijoi një precedent të rëndësishëm në drejtësi, por për forcimin e standardeve demokratike rekomandohet shtrirja graduale e mekanizmave të verifikimit të integritetit edhe tek zyrtarët e zgjedhur dhe drejtuesit e institucioneve publike.
- II. **Vendosja e indikatorëve të matshëm të performancës.** Mungesa e një sistemi të qartë vlerësimi për performancën mbetet problematikë. Vendosja e indikatorëve konkretë (kohëzgjatja e proceseve, cilësia e vendimeve, standardet etike) do të mundësonte një vlerësim objektiv dhe të lidhur me karrierën.
- III. **Rritja e transparencës së detyrueshme institucionale.** Transparenca duhet të kalojë nga praktikë në detyrim ligjor, përmes publikimit të detyrueshëm të vendimeve, statistikave dhe raporteve periodike, duke garantuar që hapja e sistemit të jetë e qëndrueshme.
- IV. **Fuqizimi i rolit të medias dhe shoqërisë civile.** Monitorimi i pavarur ka qenë një faktor kyç në suksesin e reformës. Duhet të forcohen mekanizmat e aksesit në informacion dhe reagimit institucional ndaj gjetjeve të tyre, duke i kthyer në partnerë të qëndrueshëm të llogaridhënies.
- V. **Digjitalizimi i plotë i proceseve dhe aksesit në drejtësi.** Investimi në sisteme elektronike për menaxhimin e çështjeve, publikimin online të vendimeve dhe ofrimin e shërbimeve digjitale për qytetarët është thelbësor për rritjen e efikasitetit dhe transparencës.

IX. PËRFUNDIME

Rasti i vetingut në Shqipëri për periudhën 2025–2026 përfaqëson një nga ndërhyrjet më të forta dhe më gjithëpërfshirëse në drejtim të llogaridhënies në hapësirën post-komuniste europiane. Për herë të parë, një sistem i tërë drejtësie iu nënshtrua një procesi të thellë verifikimi, ku përgjegjshmëria individuale nuk ishte më përjashtim, por rregull²⁴.

Në këtë kuadër, bilanci statistikor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA) nuk duhet lexuar thjesht si një përmbledhje shifrash. Ai përfaqëson në mënyrë konkrete dhe të matshme rezultatin e një procesi që preku drejtpërdrejt elitën e drejtësisë së mëparshme, duke vendosur një standard të ri për integritetin dhe ushtrimin e funksionit publik²⁵. Çdo çështje dhe çdo vendim përbën një pjesë të këtij bilanci, i cili në thelb pasqyron nivelin real të llogaridhënies së arritur.

Megjithatë, përtej këtij rezultati të rëndësishëm, sfida kryesore mbetet transformimi i këtij momenti në një sistem të qëndrueshëm dhe vetrregullator. Vetingu ishte një mekanizëm i jashtëzakonshëm, i cili krijoi një ndërprerje të fortë me të kaluarën, por qëndrueshmëria e reformës varet nga aftësia për ta kthyer këtë ndërhyrje në një praktikë të përhershme institucionale²⁶.

Në këtë kuptim, suksesi i vetingut nuk duhet matur vetëm me numrin e zyrtarëve të larguar apo me thellësinë e filtrimit të realizuar. Ai duhet të vlerësohet mbi bazën e asaj që sistemi arrin të ndërtojë pas këtij procesi: një drejtësi funksionale, transparente dhe të aftë për të garantuar llogaridhënie në mënyrë të vazhdueshme.

Nëse standardet e vendosura nga vetingu institucionalizohen dhe forcohen në kohë, atëherë ky proces mund të konsiderohet një pikë kthese reale në ndërtimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri. Në të kundërt, rreziku që arritjet të mbeten të përkohshme mbetet i pranishëm. Prandaj, sfida e fazës pas vetingut nuk është më ndërhyrja, por konsolidimi.

²⁴ *Reporter.al, analiza mbi ndikimin e reformës në drejtësi dhe llogaridhënie, 2024–2026.*

²⁵ *Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA), të dhëna statistikore mbi procesin e rivlerësimit, 2018–2025.*

²⁶ *Ministria e Drejtësisë, Raport monitorimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030 (Janar–Qershor 2025).*